



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 29 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 15 dhe nenit 525-529 të Kodit Nr.08/L-032 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 173 dhe nenit 183 të ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe të nenit 7 nën paragrafët 1.13, 1.24 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë, 12 qershor 2023,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2023

**PËR PROCEDURËN PËR KOMPENSIMIN E DËMIT TË PERSONAVE
TË DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është të rregulloj procedurën e kompensimit të dëmit jo material dhe material ndaj personit i cili është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky udhëzim administrativ zbatohet në të gjitha rastet për realizimin e të drejtës së kompensimit të dëmit jo material dhe material ndaj personit i cili është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin:

- 1.1. **Ligji** - Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2. **KPPRK**- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
- 1.3. **Këshilli** – Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.4. **Sekretariati i Këshillit** – Njësinë organizative brenda Këshillit, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.5. **Drejtor i Përgjithshëm** - Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.6. **Komisioni** – komision i themeluar nga Këshilli, përgjegjës për trajtimin e kërkesave për kompensimin e dëmit material dhe jo material për personin i cili është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye;
- 1.7. **Anëtar i Komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili kryen detyrat dhe përgjegjësit në pajtim me këtë udhëzim administrativ;
- 1.8. **Anëtar rezervë i Komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit apo rasteve të tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar;
- 1.9. **Sekretar i Komisionit**- zyrtarin kompetent të autorizuar për mbështetje profesionale dhe administrative të komisionit;
- 1.10. **Dëmi material** – nënkupton dëmin pasuror në emër të fitimit të munguar, shpenzimeve të mbrojtjes nga avokati, për pako dhe vizita familjare, i cili dëm mund të vlerësohet me të holla;
- 1.11. **Dëmi jo material** – mund të përfshijë humbjen e jetës, integritetin e personit, dëmtimet trupore dhe shëndetin (fizik dhe psikik) dhe lirinë;
- 1.12. **Akt Pajtimi** – marrëveshje e arritur në mes parashtruesit të kërkesës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në procedurën jashtëgjyqësore lidhur me kompensimin e dëmit siç përcaktohet me këtë udhëzim administrativ.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 4

Themelimi dhe përbërja e Komisionit

1. Komisioni themelohet nga Këshilli, nga radhët e gjyqtarëve të të gjitha niveleve të gjykatave dhe ka mandat tre (3) vjeçar pa mundësi vazhdimi.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtar të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezervë të cilët vijnë nga radhët e gjyqtarëve. Këshilli zgjedh kryetarin e komisionit nga radhët e anëtarëve të rregullt të komisionit.
3. Anëtarët e komisionit që vijnë nga radhët e gjykatës themelore duhet të jenë gjyqtarë me mandat të përhershëm.
4. Gjatë marrjes së vendimit për përbërjen e komisionit, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë.
5. Komisionin e mbështet sekretari i komisionit të cilin me vendim e cakton Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 5

Konflikti i Interesit

1. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit ka konflikt interesi me ndonjërin nga lëndët e paraqitura në seancë, i njëjti duhet menjëherë të njoftojë kryetarin e komisionit dhe lënda do të trajtohet në seancën e radhës pasi të jetë ndryshuar anëtari i komisionit.
2. Nëse kryetari i komisionit ka konflikt interesi me ndonjërin nga lëndët e paraqitura në seancë, lënda do të trajtohet në seancën e radhës pasi të jetë ndryshuar kryetari i komisionit, ku në këtë rast kryetar komisioni do të caktohet me automatizëm anëtari më i vjetër në moshë nga anëtarët e rregullt të komisionit.

Neni 6

Kompensimi i Komisionit

Kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari i komisionit për punën e tyre kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet përkatëse të miratuara nga Këshilli.

Neni 7

E drejta në kompensim

Të drejtë në kompensim bëmi sipas këtij udhëzimi administrativ ka personi i cili është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye,

ashtu siç është përcaktuar në kapitullin tridhjetë e gjashtë (36) të KPPRK-së, përkatësisht nenet 525 - 529.

Neni 8

Kompensimi për dëmin material në emër të fitimit të munguar

1. Në rastet kur personi i cili është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye, ka të drejtë të kërkoj kompensim për dëmin material që ka pësuar në emër të fitimit të munguar:

- 1.1. shuma e kompensimit që do të paguhet për personin e papunësuar do të jetë në përputhje me pagën minimale bruto të përcaktuar në Republikën e Kosovës; ndërsa,
- 1.2. shuma e kompensimit që do të paguhet për personin që ka qenë në marrëdhënie të punës do të jetë në lartësinë e shumës bruto të pagës që ai ka realizuar para se të privohej nga liria.

2. Personi i cili në kohën kur është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye, ka qenë i punësuar, me rastin e paraqitjes së kërkesës për kompensim duhet të dorëzoj kontratën origjinale të punës ose kopjen e vërtetuar nga shërbimi i noterisë, vërtetimin që dëshmon lartësinë e pagës, dëshminë e trustit pensional dhe qarkullimit bankar apo dëshmi të tjera relevante sa i përket qarkullimit bankar.

3. Personi - shtetas i Republikës së Kosovës me punë të përkohshme jashtë vendit, si dhe personi – shtetasi i huaj që është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye, me rastin e paraqitjes së kërkesës për kompensim, gjithë dokumentacionin e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni duhet të dorëzoj të përkthyer nga perkthyes të certifikuar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Kompensimi për shpenzimet e mbrojtjes

1. Personi që është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak, pa arsye, i takon kompensimi në emër të shpenzimeve të mbrojtjes nga avokati sipas tarifës së Odës së Avokatëve duke i dëshmuar përmes procesverbaleve të seancave gjyqësore të mbajtura/faturave të lëshuara.

2. Për kërkesat e hartuara nga personat tjerë fizik dhe juridik cilët nuk janë të regjistruar në Odën e Avokatëve nuk ju takon e drejta e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 10
Kompensimi dëmit material për pako dhe vizita familjare

1. Në emër të kompensimit për shpenzimet e anëtarëve të familjes për vizitat e bëra personit të mbajtur në paraburgim ose ndaj personit të dënuar me heqje të lirisë, pa arsye, për dërgimin e pakove si dhe shpenzimet tjera të transportit për anëtarët e familjes, kanë të drejtë në kompensim në vlerë prej pesëdhjetë (50) euro për një vizitë, por nuk kanë të drejtë kompensimi më shumë se dy (2) herë brenda muajit, përkatësisht shumën maksimale prej njëqind (100) euro.

2. Kompensimi sipas paragrafit 1 të këtij neni realizohet në dy (2) periudha, periudha e parë përfshin datën 01-15, ndërsa periudha e dytë përfshin datën 16-31 të muajit përkatës.

Neni 11
Kompensimi për dëmin jo-material

1. Për dëmin jo material, në emër të dhimbjeve të përjetuara shpirtërore, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit ndaj personit i cili është mbajtur në paraburgim ose ka mbajtur dënim me heqje të lirisë, kompensohet në shumën prej njëzetepesë (25) euro në ditë.

2. Për dëmin jo material, në emër të dhimbjeve të përjetuara shpirtërore, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, ndaj personit i cili është mbajtur në arrest shtëpiak, kompensohet në shumën prej pesëmbëdhjetë (15) euro në ditë.

Neni 12
Caktimi dhe mbajtja e seancave

1. Seancat e komisionit i cakton kryetari i komisionit në koordinim me sekretarin e komisionit. Seancat çdo herë duhet të caktohen pas orarit të rregullt të punës ose ditëve jo të punës, në objektin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës apo të Gjykatës Supreme.

2. Seancën e udhëheq kryetari i komisionit, përkatësisht ndonjëri anëtar i komisionit me autorizim paraprak të kryetarit.

3. Numri i seancave mujore nuk është i kufizuar dhe ato mbahen varësisht nga numri i lëndëve që presin për t'u zgjidhur, sipas radhës së pranimit.

4. Komisioni sipas këtij udhëzimi është i detyruar që për çdo seancë pune të shqyrtoj, përgatit dhe vendos së paku pesë (5) lëndë.

Neni 13

Paraqitja e kërkesës për kompensim dëmit

1. Personi i cili është mbajtur në paraburgim, ka mbajtur dënim me heqje të lirisë si dhe është mbajtur në arrest shtëpiak pa arsye, ka të drejtë që personalisht apo përmes të autorizuarit të tij të paraqes kërkesë për kompensim dëmi. Kërkesa mund të dorëzohet në zyrën e pranimit të Sekretariatit të Këshillit në formë fizike, apo me postë në dy (2) kopje ose postë elektronike, duke i bashkangjitur vendimin gjyqësor të formës së prerë në origjinal ose kopje të vërtetuar si dhe dëshmitë të cilat arsyetojnë kërkesën për kompensim dëmit.
2. Zyra e pranimit e Sekretariatit të Këshillit pasi që ta pranoj kërkesën për kompensim, e evidenton me datë të pranimit dhe me numër rendor dhe pastaj ia dorëzon sekretarit të komisionit.
3. Për çdo kërkesë të pranuar komisioni vendosë më së largu në afat prej tre (3) muaj duke llogaritur nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 14

Përgatitja e materialit për seancë

1. Pas pranimit të dokumentacionit të nevojshëm, sekretari i komisionit në bashkëpunim dhe koordinim me kryetarin e komisionit bënë përgatitjen e materialit për seancë të komisionit.
2. Në rast të paqartësive në dokumentacion, sekretari i komisionit sipas udhëzimeve të dhëna nga kryetari i komisionit mund të kërkoj nga gjykata ku është zhvilluar procedura penale shkresat e lëndës të parashtruesit të kërkesës për kompensim dëmi.
3. Kur materiali të jetë gati, kryetari në koordinim me sekretarin e komisionit e caktojnë datën e mbajtjes së seancës.

Neni 15

Akt pajtimi

1. Nëse pala gjatë procedurës për kompensim dëmi, pajtohet me shumën e ofruar të dhënë nga komisioni, atëherë lidhet akt pajtimi sipas ligjit përkatës për procedurën administrative, e cila i shërben si titull ekzekutiv për realizimin e kërkesës së tij.
2. Nëse pala nuk pajtohet me shumën e ofruar nga ana e komisionit për asnjë lloj dëmi material dhe jo material të kërkuar, me këtë e fiton të drejtën që në procedurën e rregullt gjyqësore, me padi civile të kërkoj kompensimin e dëmit të pretenduar që i është shkaktuar.

3. Nëse pala gjatë procedurës për kompensim dëmi, pajtohet për disa nga kompensimet e kërkuara të parapara në këtë udhëzim administrativ, atëherë për atë pjesë lidhet akt pajtimi, ndërsa për pjesën për të cilën nuk është pajtuar me shumën e ofruar lidhur me kompensimet e fiton të drejtën që në procedurën e rregullt gjyqësore, me padi civile të kërkoj kompensimin e dëmit, për të cilën konsideron apo ka pretendime se i takon.

Neni 16 **Ekzekutimi i pagesës**

1. Sekretari i komisionit jo më larg se në afat prej shtatë (7) ditëve duke llogaritur nga dita e arritjes së akt pajtimit është përgjegjës për procedimin e lëndës përfshirë, kërkesën për kompensim, aktin e pajtimit si dhe dosjen penale, me qëllim të ekzekutimit të kompensimit të dëmit.

2. Departamenti për Buxhet dhe Financa në Sekretariatit të Këshillit, është i detyruar që të bëjë ekzekutimin e kompensimit të shumave për dëmin, ashtu siç përcaktohet me këtë udhëzim administrativ dhe atë në afat jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e arritjes së akt pajtimit.

Neni 17 **Publikimi i listës së kompensimit të personave të dënuar ose arrestuar pa arsye**

1. Komisioni, më së largu deri në përfundim të tre mujorit të parë të vitit pasues publikon listën e kompensimit të dëmit të personave të dënuar ose arrestuar pa arsye në formë raporti vjetor për vitin e kaluar në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Lista e kompensimit të personave të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, duhet përfshij periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor të secilit vit dhe duhet të përmbaj të dhënat si në vijim:

- 2.1. inicialet e personit të kompensuar;
- 2.2. gjykatën/prokurorinë të cilat kanë nxjerr vendimin;
- 2.3. numrin e lëndës dhe datën e nxjerrjes së vendimit;
- 2.4. periudhën e qëndrimit në paraburgim/arrest shtëpiak;
- 2.5. ditët e qëndrimit në paraburgim/ arrest shtëpiak;
- 2.6. kompensimin për dëmin material dhe jo material si dhe shumën totale për secilin person;
- 2.7. shumën e përgjithshme të kompensuar gjatë gjithë vitit;
- 2.8. listën e personave që kanë pranuar pjesërisht kompensimin;
- 2.9. listën e personave që iu është refuzuar kërkesa për kompensim;
- 2.10. listën e personave që kanë refuzuar ofertën jashtëgjyqësorë të ofruar nga komisioni.

Neni 18
Dispozitat Shfuqizuese


Me hyrje në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (04/2015) për Zbatimin e Procedurës për Kompensimin e Dëmit për Persona të Dënuar ose të Arrestuar pa arsye.


Neni 19
Dispozitat Kalimtare

Të gjitha kërkesat e parashtruara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi të cilat nuk janë vendos nga ana e komisionit, do të trajtohen sipas këtij udhëzimi administrativ.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës


Datë: 24 . 06 . 2023